



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 34-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 27.02.2025, në sallën numër 2, kati i 3-të, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Valon Pacolli, DEZH
2. Shkelzen Hajdini DSHPS
3. Rexhep Rexhepi, DBPZHR
4. Burim Rustemi, DSHPMSh

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Naser Bytyqi**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës se bashku me material e keni marr me kohë të cilin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 33-të e KPF-së.
2. Propozim Vendim për lirim nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.
3. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore për vendosjen e trafostacionit të ri të tipit shtyllë betoni në Sllovi.
4. Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë.
5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës-lokaleve afariste në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë.

Pastaj kryesuesi tha se me kërkesë të ekzekutivit kemi edhe një pike shtesë cilën tani po ua shpërndajmë.

6. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për iniciativën për zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës –IADK.

Pas votimit u aprovua rendi i ditës me pikën shtesë për këtë mbledhje dhe u kalua në pikën e parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 33-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për, Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 33-të të KPF-së.

II

Propozim Vendim për lirimin nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile të përfituesve të banimit social.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Shkelzen Hajdinit drejtor i DSHPS , i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim vendimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimin dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin.

III

Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës-pasuri shoqërore për vendosjen e trafostacionit të ri të tipit shtyllë betoni në Sllovi.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Burim Rustemit drejtor i DSHPMSh, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Alban Salihu tha është obligim i komunës për përmirësimin e gjendjes për furnizimin me energji elektrike.

Daut Azemi tha se fillimisht qytetaret duhet të bëjnë kërkesën për përmirësim të rrjetit, në kopanin e KEDS-it dhe të kërkojnë investimet për përmirësimin e rrjetit ndërsa ne ju dalim në ndihmë dhe ndajmë hapësirat për vendosjen e trafo ve dhe rrjeteve të reja.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim Propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për, aprovoi propozimin.

IV

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë

.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Valon Pacolli drejtor DEZH-së i cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari tha se ka pyetje rreth këtij propozim vendimi lidhur me atë se çmimi duhet të jetë i diskutueshëm për arsye se edhe më herët për këtë lokal nuk ka pasur oferta serioze për shkakë të lagështisë dhe pozitës së tij.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF – ja me 7 vota për , aprovoi propozimin.

V

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës-lokaleve afariste në Zonat Kadastrale Lipjan dhe Magurë

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, i cili ia kaloi fjalën Valon Pacolli drejtor DEZH i cil i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim Propozim Vendimin dhe pas votimit konstatoi se KPF - ja me te gjitha votat për, aprovoi propozimin.

VI

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për iniciativën për zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës –IADK.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia kaloi fjalën Rexhep Rexhepit DBPZHR, , cili njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozim Vendimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF- ja me 7 vota për , aprovoi Propozim Vendimin.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:00

Ekstraktin e hartoi
Emine Mustafa Deliu

Kryesuesi i Komitetit
Daut Azemi